



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05 nr.350/0 – 61655/21 dt.02.04.2021**, në emër të pronarëve: Sabri Bekteshi, Bahtijar Bytyqi, Fahredin Qyqalla nga Prishtina dhe Investitori "Diamond Group" L.L.C. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK nr.810838732, me përfaqësues Jeton Selimi, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa 2B+S+P+5, në kuadër të Bllokut urban "A-10", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht parcelave: nr.762-3, 762-6, 762-7 dhe 762-18 ZK Matičan, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **27.04.2021** deri me datën **11.05.2021** në Email adresën: urbanizmi@prishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa 2B+S+P+5	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor / "Arë e Klasës 5" – Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.00 m' Sipas Planit rregullues "Mati 1"
c. Vija ndërtimore	3.0 m' Sipas Planit rregullues "Mati 1"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	8.0m' /18m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 8.60/18m' & 2.5m'/18m' Pasmë : 3.9m'/18m' & 3.0m'/18m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	3,084.18m ² sip. Ndërtimore mbi tokë
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	60% - ose 661.20m ² i lejuar dhe 478.61m ² propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	20%- sipas PRRU "Mati 1" e lejuar, 22.70% e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% ose 661.20m ² lejuar dhe 645.47m ² - propozuar,
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	30 VP
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga pranimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____

